

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6736
E enjte, 20 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Abdyl Krasniqi, një nga viganët që rriti Kosova për t'i dhënë lirinë | FAQE 3



Nga Azem SYLA, ish-komandant i përgjithshëm i UÇK-së

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ESCOBARI: ARRITJA E NJË MARRËVESHJEJE PËR RRUGËN PËRPARA MES KOSOVËS E SERBISË, ÇËSHTJE JAVËSH | FAQE 3



I dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së një marrëveshjeje. "Iu përket të dyja palëve dhe ndërmjetësuesit që të vendosin afate

kohore. Duke pasur parasysh kontekstin e asaj që po ndodh, të gjithë duhet të ngrihen dhe të marrin përgjegjësi për të krijuar stabilitet jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon", ka theksuar Escobari

AKTUALE



ÇFARË DIHET PËR PROPOZIMIN FRANKO-GJERMAN? F. 4-5

POLICIA ARRESTON NJË PERSON TË DYSHUAR PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË F. 7

NUK KALON PROJEKTLIGJI PËR MASAT E PËRKOHSHE TË PRODUKTEVE THEMELORE F. 5

EKONOMI



GËRXLIAU: NË KËTË KOHË A KA KUPTIM TË FLITET PËR 260 EURO PAGË MINIMALE? F. 8

STUDENTËT MUND TË APLIKOJNË PËR MARRJEN E 100 EUROVE NGA SHTETI F. 8

SPORT



ROBIN MITCHELLI EMËROHET PRESIDENT I ANOC-ut F. 10



TAHIRI: ASOCIACIONI ËSHTË PUNË E KURTIT, KA ARDHUR NË PUSHTET DUKE E KUNDËRSHTUAR



OSMANI: LIBERALIZIMI I VIZAVE NUK DUHET TË MBETET PENG I TEKNIKALITETEVE TË REJA | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.prinesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Liz Truss jep dorëheqje nga pozita e kryeministres së Britanisë së Madhe

LONDËR, 20 TETOR - Liz Truss, kryeministria e Britanisë së Madhe, dha dorëheqje këtë të enjte, 44 ditë pasi mori drejtimin e qeverisë. Truss u vu në qendër të polemikave për një plan të dështuar për uljen e taksave të paraqitur nga qeveria në muajin e kaluar. Plani ekonomik shkaktoi trazira financiare dhe një krizë politike që solli dhe shkarkimin e ministrit të Financave të Truss, ndryshime të politikave dhe një përplasje të brendshme në Partinë Konservatore në pushtet.

Në një konferencë për medie, Truss ka theksuar se i ka paraqitur dorëheqjen Mbretit dhe zgjedhjet për kryetarin e ardhshëm të Partisë Konservatore do të

zhvillohen brenda një jave. "Mora detyrën në një kohë paqëndrueshmërie të madhe ekonomike dhe ndërkombëtare. Familjet dhe bizneset ishin të shqetësuar sesi do t'i paguanin faturat. Lufta e jashtëligjshme e Putinit në Ukrainë kërcënon sigurinë e të gjithë kontinentit tonë. Dhe vendi ynë është frenuar për një kohë të gjatë nga rritja e ulët ekonomike. Unë u zgjodha nga Partia Konservatore për ta ndryshuar këtë situatë. Kemi arritur t'i shkurtojmë faturat e energjisë dhe ato të sigurimeve shëndetësore. Ne përcaktuam një vizion për një ekonomi me rritje të lartë dhe me taksë të ulëta që do të përfitonin nga Brexitit. E pranoj se,

duke pasur parasysh situatën, nuk mund ta përmbush mandatin me të cilin jam zgjedhur nga Partia Konservatore. Prandaj i kam treguar madhërisë së tij, Mbretit, se po jap dorëheqje si lidere e Partisë Konservatore", ka deklaruar Truss.

Vendimi për dorëheqje vjen pasi një prej ministrave të kabinetit të saj dha dorëheqje të enjten.

Liz Truss bëhet kështu kryeministria me mandatin më të shkurtër në historinë e Britanisë së Madhe, duke dhënë dorëheqje vetëm gjashtë javë pasi mori detyrën.

Truss pati deklaruar se do të qëndrojë në detyrë derisa të caktohej pasardhësi i saj.



Spanja, Franca dhe Portugalia arrijnë marrëveshje për ndërtimin e tubacionit të gazit



MADRID, 20 TETOR - Të enjten, më 20 tetor, kryeministri spanjoll Pedro Sanchez tha se Spanja, Franca dhe Portugalia kishin rënë dakord për të ndërtuar një tubacion energjie që lidh Gadishullin Iberik me pjesën tjetër të Evropës.

Projekti i ri, të cilin kryeministri Sanchez e quajti një "Korridor të Energjisë së Gjellbër", do ta zëvendësojë planin e mëparshëm të quajtur "MidCat" të propozuar një dekadë më parë, por u pezullua në vitin 2019 për shkak të çështjeve rregullatore dhe mungesës së financimit.

Por, me Rusinë që po kufizon dërgesat e gazit në pjesën më të madhe të Evropës si reagim ndaj

sanksioneve për pushtimin e Ukrainës, ka pasur një ringjallje të interesit për t'i sjellë furnizimet e nevojshme nga Spanja në pjesën tjetër të kontinentit.

Me rritjen e çmimeve të energjisë, Madridi u përpoq për ringjalljen e projektit, me mbështetjen e plotë të Berlinit, i cili po vuan mbylljen e furnizimeve të gazit rus nëpërmjet tubacionit "Rrjedha e Veriut 1" për një kohë të pacaktuar.

"Ne kemi rënë dakord për... një projekt të ri që do të quhet 'Korridori i Energjisë së Gjellbër', që do ta lidhë Gadishullin Iberik me Francën dhe, si rrjedhojë, me tregun evropian të energjisë midis Barcelonës dhe Marsejës",

shpjegoi Sanchez pas mbërritjes së tij për një samit të BE-së mbi krizën energetike.

Sanchez tha se tubacioni të shërbejë për hidrogjenin dhe gazin e lëngshëm "gjatë një periudhe tranzicioni të nevojshme për tregun evropian të energjisë".

Spanja aktualisht ka gjashtë terminale të gazit natyror të lëngshëm për përpunimin e gazit që mbërrin nga deti, gjë që mund ta ndihmojë BE-në t'i rrisë importet me një furnitor më të mirë.

Por ka vetëm dy lidhje me kapacitet të ulët me rrjetin e gazit të Francës, i cili ka lidhje me pjesën tjetër të Evropës.

Scholz: Taktikat e tokës së djegur nuk do t'i ndihmojnë Putinit

BERLIN, 20 TETOR - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë të enjten se presidenti rus Vladimir Putin është duke përdorur energjinë dhe krizën e urisë si armë, mirëpo ka dështuar që ta thyejë unitetin e Perëndimit dhe nuk do t'i arrijë synimet e tij përmes taktikave për djegie të tokave.

Duke folur para Parlamentit gjerman, ai ka thënë se Gjermania e ka liruar veten nga varësia e gazit rus, mirëpo është duke punuar për uljen e çmimeve, përfshirë sigurimin e kontratave të reja për furnizim me gaz nga shtetet e tjera. Ushtria ruse e ka dëmtuar rëndë infrastrukturën e energjisë në Ukrainë ditët e fundit, duke nxitur autoritetet ukrainase që të

vendosin kufizime në konsum të rrymës për herë të parë që prej nisjes së luftës.

Rusia, në anën tjetër, ka mohuar se shënjestron civilët.

"Nuk do ta lëmë pa përgjigje përshkallëzimin e fundit të Moskës... taktikat e tokës së djegur nuk do t'i ndihmojnë Rusisë që ta fitojë luftën. Ne vetëm do ta vazhdojmë forcimin e unitetit dhe vendosmërinë e Ukrainës e të partnerëve të saj", ka thënë Scholz para Parlamentit gjerman.

"Të gjitha gënjeshttrat dhe propaganda, bisedimet për 'operacione speciale' dhe fitoret e shpejta, janë fasadë", ka thënë ai. Më 20 tetor kompania ukrainase e rrjetit energjetik "Ukrenergo" u ka bërë thirrje banorëve që t'i



"mbushin të gjitha bateritë" para nisjes së kufizimeve në furnizim

me energji, duke paralajmëruar edhe për ndërprerje totale të

energjisë nëse nuk kursehet rryma.

Oleksandr Kharchenko, këshilltar në Ministrinë e Energjisë, ka thënë më 19 tetor se, sipas të dhënave të reja, rreth 40 për qind e infrastrukturës totale është dëmtuar seriozisht.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke e goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Escobari: Arritja e një marrëveshjeje për rrugën përpara mes Kosovës e Serbisë, çështje javësh



I dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së një marrëveshjeje. “Iu përket të dyja palëve dhe ndërmjetësuesit që të vendosin afate kohore. Duke pasur parasysh kontekstin e asaj që po ndodh, të gjithë duhet të ngrihen dhe të marrin përgjegjësi për të krijuar stabilitet jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon”, ka theksuar Escobari

PRISHTINË, 20 TETOR - I dërguari i posaçëm i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së një marrëveshjeje, duke theksuar se ka dëgjuar nga kolegët evropianë se bëhet fjalë për “çështje javësh dhe jo vitesh”.

Gjatë një interviste për televizionin “Kanal 10”, Escobari u pyet nëse bëhet fjalë për arritjen e një marrëveshjeje mbi propozimin e Francës dhe Gjermanisë, që thuhet se u është dorëzuar liderëve të Kosovës dhe të Serbisë. Por, ai tha se bëhet fjalë për “një marrëveshjeje për rrugën përpara”. “Prandaj, përtej kësaj, iu përket të dyja palëve dhe ndërmjetësuesit që të vendosin afate kohore, por duhet të jetë e

shpejtë. Duke pasur parasysh kontekstin e asaj që po ndodh, të gjithë duhet të ngrihen dhe të marrin përgjegjësi për të krijuar stabilitet jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon. Ne do të donim ta shihnim Kosovën që të rreshtohet më shumë sa iu përket çështjeve të stabilitetit rajonal dhe kjo është mënyra se si mund ta bëjnë”, tha ai.

Duke folur mbi propozimin e Francës dhe Gjermanisë, që thuhet se ua kanë dorëzuar liderëve të Kosovës dhe Serbisë për arritjen e një marrëveshjeje, Escobari tha se ShBA-ja mbështet këtë propozim dhe çfarëdo që shtetet evropiane sugjerojnë përmes dialogut që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, duke porositur Kosovën

dhe Serbinë që të marrin seriozisht propozimin. “Ne mendojmë, sikurse na është shpjeguar, se ky propozim do të nënkuptonte angazhim dhe integrim më të afërt të Kosovës, potencialisht të Serbisë në integrimet euroatlantike”, ka deklaruar Escobari.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se propozimi franko-gjerman konsiston në atë që shteti i tij të lejojë që Kosova të anëtarësohet në institucione dhe organizata ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, në këmbim të anëtarësimit të shpejtë të Serbisë në BE.

Escobari ka thënë se “ne gjithmonë e kemi përkrahur njohjen e Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran dhe ne do ta

mirëprisnim në OKB dhe në të gjitha strukturat e tjera evropiane”. Pavarësisht se propozimi franko-gjerman, siç është raportuar, nuk përfshin njohjen reciproke, Escobari tha se njohja reciproke “do të ndodhë”. “Çështje është koha se kur do të ndodhë. Por, ajo që është më e rëndësishme për Kosovën, është që të nisë një rrugë më të qëndrueshme drejt integritit në strukturat euroatlantike, duke përfshirë edhe njohjen nga pesë shtetet mosnjohëse të BE-së”, është shprehur Escobari.

Sa i përket propozimit franko-gjerman, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nuk ka një propozim për marrëveshje finale. Escobari, po ashtu, ka thënë se kanë kërkuar që Kosova ta shtyjë për dhjetë muaj afatin për reregjistrimin e targave që lëshohen nga Serbia në targa RKS-Republika e Kosovës. “Nuk është sekret që ne kemi kërkuar një periudhë më të gjatë të zbatimit [të vendimit për reregjistrim] deri në 10 muaj të tjerë. Do të doja të shihja që kjo të ndodhte. Kjo nuk është vetëm kërkesë e ShBA-së,

por e gjithë shteteve të Quintit, për shkak se ne jemi shtetet që e përkrahim më së shumti Kosovën. Besojmë se është e rëndësishme që kur ne bëjmë rekomandime, njerëzit t'i dëgjojnë ato”, ka thënë Escobari, teksa afati për këtë proces pritet të përmbyllet më 31 tetor.

Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë ka nisur më 2011 dhe ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian. Së fundmi, Franca dhe Gjermania kanë shtuar përpjekjet për t'i shtyrë Prishtinën dhe Beogradin drejt arritjes së një marrëveshjeje.

Kancelari gjerman Olaf Scholz dhe presidenti francez Emmanuel Macron përmes një letre dërguar Kurtit dhe Vuçiqit më 4 shtator u kërkuar të jenë të gatshëm për vendime të vështira në dialog. Kosova dhe Serbia kanë qëndrime të kundërta sa i përket përfundimit të dialogut. Përdërisa Kosova kërkon që një marrëveshjeje përfundimtare ta përfshijë njohjen reciproke, Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, por pa specifikuar se për çfarë zgjidhje bëhet fjalë.

Tahiri: Asociacioni është punë e Kurtit, ka ardhur në pushtet duke e kundërshtuar

PRISHTINË, 20 TETOR - Ish-kryenegociatorja e Kosovës, Edita Tahiri, ka reaguar në lidhje me një dokument që është duke qarkulluar në media për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Tahiri ka thënë se

asociacioni është punë e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, i cili ka ardhur në pushtet duke e kundërshtuar atë. “Emisari amerikan Escobar kërkoi nga Kurti përgjigje për asociacionin. Ky dokument ka dalë sot në

media. Për shumë media që më kanë shkruar sot për ta komentuar, përgjigja ime është kjo: Asociacioni është punë e Kurtit, ka ardhur në pushtet duke e kundërshtuar, tani atë duhet ta pyesni”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.





Çfarë dihet për propozimin franko-gjerman?

PRISHTINË, 20 TETOR - "Nuk ka asgjë konkrete". "Është joserioze ta hedhësh nga dritarja propozimin franko-gjerman". "Gjithçka që vjen nga vendet evropiane duhet marrë seriozisht".

Këto janë vetëm disa nga deklaratat e zyrtarëve kosovarë, serbë dhe ndërkombëtarë në lidhje me të ashtuquajturin propozim franko-gjerman i cili do të duhej të hapte rrugë për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi.

Rreth një muaj më parë në opinion dolën informacione se Franca dhe Gjermania u kanë dhënë liderëve të Kosovës dhe Serbisë një propozim se si të zgjidhet kontesti i kahershëm ndërmjet dy vendeve. Që nga viti 2012 Kosova dhe Serbia kanë zhvilluar një dialog politik për normalizimin e marrëdhënieve me ndërmjetësimin e BE-së.

Aktualisht synohet arritja e një marrëveshjeje përfundimtare mes dy vendeve për normalizimin e marrëdhënieve - gjë që ende nuk ka ndodhur. Dialogu është ndërprerë disa herë.

Në vitin 2008 Kosova ka shpallur pavarësinë, të cilën Serbia nuk e njeh.

Cili është propozimi franko-gjerman?

Propozimi franko-gjerman nuk është bërë publik dhe nuk dihet se çfarë përmban saktësisht. Ambasada e Francës dhe e Gjermanisë në Kosovë nuk e kanë konfirmuar ekzistimin e një dokumenti të tillë.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, përmes deklaratave të tyre, kanë konfirmuar se kanë njohuri për një propozim të tillë. Vuçiqi, më 8 tetor, tha se Franca dhe Gjermania kanë propozuar që Serbia ta lejojë hyrjen e Kosovës në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë Kombet e Bashkuara, në këmbim të anëtarësimit të shpejtë të Serbisë në Bashkimin Evropian. Ai shtoi se Serbia nuk do të "poshtërohet më tej dhe nuk do të detyrohet ta njohë zyrtarisht Kosovën" por, duke mos reaguuar, do të jepte sinjal të heshtur se pajtohet. Ai tha se kjo është e papranueshme për Serbinë, por shtoi se është e papërgjegjshme dhe joserioze që propozimi franko-gjerman të

hidhet nga dritarja.

Më 18 tetor Vuçiqi përsëriti se thelbi i propozimit të Gjermanisë dhe Francës është që Serbia të mos e bllokojë anëtarësimin e Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare. Për këtë, siç tha ai, Serbia do të kishte "hyrje të shpejtë në BE dhe, ndoshta, përfitime të konsiderueshme ekonomike".

Çfarë kanë thënë në Kosovë?

Më 10 tetor kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, deklaroi se ekziston "një iniciativë franko-gjermane, e cila dëshiron t'i japë edhe më shumë fuqi (të dërguarit të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçakut, sikurse që i jep edhe mbështetja e vazhdueshme amerikane". "Diskutohen modele të ndryshme, por nuk ka diçka përfundimtare dhe aq më pak vendimtare, që do të mund të thuhej se ky është propozimi francezo-gjerman. Më shumë ka, si të them, ide që

qarkullojnë, Berlin, Bruksel, Uashington, por edhe Londër, Romë e Paris, si dhe Beograd dhe Prishtinë", tha Kurti dhe shtoi se, për shkak të konfidencialitetit të bisedimeve, nuk mund t'i hedhë në opinion idetë.

Më 9 tetor Kurti deklaroi se është optimist se në muajt e ardhshëm do të mund të arrihet një marrëveshje ligjërish obliguese me Serbinë, më pas kryeministri i Kosovës tha se "kanë mbetur më pak se dy vjet për të arritur marrëveshje me Serbinë".

Ndërkaq, zëvendësi i tij, Besnik Bislimi, konfirmoi për mediet në Prishtinë se ka një afat, brenda të cilit Prishtina zyrtare duhet të deklarohet nëse e pranon propozimin franko-gjerman.

Çfarë thanë të dërguarit e posaçëm?

Javën e kaluar, i dërguari special i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, i pyetur për ta komentuar propozimin franko-gjerman, tha se tani është momenti i duhur për

normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy palëve.

Më 19 tetor, i dërguari i posaçëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, duke iu përgjigjur pyetjes së një gazetari në Prishtinë, në lidhje me propozimin franko-gjerman, tha se "çfarëdo që të propozojnë vendet evropiane në lidhje me dialogun, duhet marrë seriozisht". "Ne do ta mbështesim atë", tha Escobari. Ai shtoi se, siç i është shpjeguar, "ky propozim do ta zhblokonte Kosovën, por potencialisht edhe Serbinë në rrugën e integritimit euroatlantike". Ai tha se Kosova dhe Serbia janë afër arritjes së marrëveshjes, duke theksuar se ka dëgjuar nga kolegët nga Evropa se kjo është "çështje javësh dhe jo vitesh".

Escobari sqaroi se bëhet fjalë për një marrëveshje për hapat e ardhshëm.

Edhe pse, siç thuhet në opinion, propozimi franko-gjerman nuk parasheh njohje reciproke të Kosovës dhe Serbisë, Escobari tha se kjo do të ndodhë dikur - çështja është vetëm se kur do të ndodhë.

Nuk kalon Projektligji për masat e përkohshme të produkteve themelore

PRISHTINË, 20 TETOR - Tri partitë më të mëdha opozitare në Kuvendin e Kosovës kanë thënë të enjten se nuk do ta mbështesin Projektligjin e hartuar nga Qeveria e Kosovës për vendosjen e çmimeve tavan në produktet themelore.

Çmimi tavan është çmimi maksimal i lejuar ligjërisht në një shtet.

Sipas Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), versioni që u është paraqitur në seancën e Kuvendit është i papranueshëm.

Në momentin e votimit në sallë kanë qenë 79 deputetë, mirëpo vetëm 58 prej tyre kanë marrë pjesë në votim dhe Kuvendi shkoi në pauzë.

Sërish në vazhdimin e seancës Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta miratojë Projektligjin për masat e përkohshme të produkteve themelore i propozuar nga qeveria.

Përkundër që 70 deputetë morën pjesë në vazhdim të seancës plenare, vetëm 57 deputetë morën pjesë në votim, andaj u vendos që kjo pikë të mbetet për shqyrtim në një seancë tjetër ku do të ketë kuorum.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Qeverinë e Kosovës, Rozeta Hajdari, ka thënë të enjten se Projektligji për masat e përkohshme të produkteve themelore është hartuar për shkak të "rritjes së paarsyeshme të çmimeve bazë dhe ankesave të shumta të qytetarëve, lidhur me rritjen e menjëhershme të çmimeve të gjitha produktet bazë".

Sipas saj, ky ligj do të aplikohet në



raste të veçanta të destabilizimit në treg. "Ky ligj zbatohet ndaj operatorëve ekonomikë që tregtojnë produkte themelore", ka deklaruar ajo. Produktet themelore sipas këtij projektligji janë: drithërat, buka, mielli, orizi, pastat, vaj ushqimor i lulediellit, qumështi, kripa e kuzhinës, vezë, pulë, mish i pulës, sheqeri kristalor, produktet e higjienës personale, lëndët e drurit për djegie.

Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se krizat globale po e prekin edhe Kosovën. Sipas saj, Qeveria dhe Kuvendi

kanë marrë disa veprime për t'i ndihmuar qytetarët, po ato nuk kanë ndikuar në uljen e "abuzimit me çmimet".

Ferat Shala nga PDK-ja ka thënë se ky dokument është i dëmshëm për ekonominë, konsumatorët dhe operatorët. Në mesin e atyre që i ka konsideruar defekte, kanë qenë edhe mospërfshirja e inspektorateve dhe Agjencisë së Konkurrencës.

Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, ka thënë se ky projektligj shkel Kushtetutën e Kosovës dhe se me vendosjen e çmimeve tavan mohohet konkurrenca. "Ne jemi

ekonomi e tregut të lirë për shkak se kështu e përcakton neni 10 i Kushtetutës. Kjo nënkupton ndërhyrje minimale të shtetit dhe se çmimet rregullohen në bazë të konkurrencës, ofertës dhe kërkesës", ka thënë Bajrami. Sipas saj, me këtë projektligj do të përfitojnë vetëm tregtarët e mëdhenj.

Pal Lekaj nga AAK-ja ka përmendur, po ashtu, Kushtetutën dhe ka konsideruar se projektligji dëmton rëndë tregun e lirë. "Ne si AAK kemi kërkuar dhe jemi më shumë për largimin e TVSh-së (Tatimit mbi Vlerën e Shtuar) për produktet

bazë sesa për këtë projektligj. Këtë projektligj nuk do ta përkrahim në parim. Do ta përkrahim vetëm atëherë kur të bëhen ndryshime rrënjësore", ka thënë ai.

Në Kosovë, sipas Agjencisë së Statistikave, inflacioni në muajin shtator ka arritur në 12.7 për qind, krahasuar me 0.2 për qind sa ka qenë në shtator të vitit të kaluar. Rritja e kërkesës për produkte dhe shërbime të tjera, pas heqjes së masave kufizuese për luftim të pandemisë së koronavirusit dhe lufta e Rusisë në Ukrainë, besohet se janë dy shkaqet kyçe që kanë ndikuar në rritje të inflacionit në shumë vende të botës.

Çfarë thanë analistët?

Dushan Janjiq, nga Forumi për Marrëdhëniet Etnike në Beograd, tha në një deklaratë të mëhershme për "Radion Evropa e Lirë" se dokumenti franko-gjerman u publikua si një "pyetje testuese". "Nuk e di se me marrëveshjen e kujt është bërë kjo – pra, të çështjes së statusit, çështjes së definimit të zgjidhjes përfundimtare. Dhe, ajo sillet nëpër opinion. Unë, me sa di, ka mjaft çështje brenda, përndryshe kjo letër do të ishte e padobishme. Kjo letër bart qëndrimin e Gjermanisë dhe Francës. Për të duhet të deklarohen Prishtina dhe Beogradi, por do të shohim reagime edhe të Britanisë [së Madhe]. Do të ishte ideale që një ditë, [propozimi] të shndërrohet në platformë të përbashkët për negociatë", tha Janjiq. "Mendoj

se ky është fillimi i fushatës që të pranohet ky model. Cili është ky model? Disa e quajnë si 'modeli i dy Gjermanive' dhe kjo është e mira e kësaj letre. Mendoj se në këto rrethana, as Prishtina dhe as Beogradi nuk do të marrin ofertë më të mirë. E ajo është që Serbia ta pranojë ekzistencën e Republikës së Kosovës. Pra, që Serbia të mos e pengojë anëtarësimin e Kosovës [në organizata ndërkombëtare] dhe të bashkëpunojë me Kosovën kur kanë interesa të përbashkëta në organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe Kombet e Bashkuara", u shpreh Janjiq.

Bodo Weber, ekspert për Ballkanin dhe bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politikën e Demokratizimit në Berlin, i tha "Radion Evropa e Lirë", më 19 tetor, se për momentin askush nuk e di se çfarë përmban konkretisht propozimi franko-gjerman. Ai tha se propozimi

mund ta ndryshojë rrjedhën e dialogut, por vlerësoi se Kosova dhe Serbia janë ende larg një marrëveshjeje përfundimtare.

A është i nevojshëm propozimi franko-gjerman dhe pse?

Kurti dhe Vuçiqi aktualisht janë duke zhvilluar një dialog të nivelit më të lartë politik, i cili filloi në vitin 2012 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Për shkak të qëndrimeve konfrontuese të të dyja palëve, në disa raste gjatë viteve të kaluara ka pasur bllokime apo ndërprerje të dialogut.

Janë nënshkruar më shumë se 30 marrëveshje në fusha të ndryshme, por shumica e tyre nuk janë zbatuar plotësisht. Në vitet e fundit ka pasur rritje të tensioneve në terren, pas të

cilave përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar shpesh janë nisur në "mision" për uljen e tyre përmes së ashtuquajturës diplomaci fluturuese.

Një krizë e tillë ndodhi më 31 korrik, kur disa serbë lokalë në veri të Kosovës, ku përbëjnë shumicën, edhe një herë ngritën barrikada, me qëllim që ta pengonin Qeverinë e Kosovës që t'i zbatonte vendimet për reregjistrimin me targa të Kosovës të automjeteve që bartin targa të paligjshme të lëshuara nga Serbia, si dhe për lëshimin e dokumenteve për qytetarët serbë të cilat do ta zëvendësonin letërnjoftimin e tyre. Praktikën e tillë me dokumente, Serbia e ka përdorur me vite për qytetarët e Kosovës.

Pas "ndërhyrjes" së diplomatëve të huaj, situata u stabilizua, por komuniteti ndërkombëtar ua bëri të qartë palëve se nuk do të

"toleronte më" destabilizimin. Kështu, më 4 shtator, presidenti francez Emmanuel Macron dhe kancelari gjerman Olaf Scholz i kanë bërë thirrje Kurtit dhe Vuçiqit që të tregojnë vendosmëri dhe gatishmëri maksimale për të marrë vendime të vështira, të cilat çojnë kah përparimi në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Më pas, ata vendosën që këshilltarët e tyre, Emmanuel Bonne dhe Jens Plotner, ta "ndihmonin" Kurtin dhe Vuçiqin në marrjen e atyre vendimeve të vështira.

Shumë shpejt në opinion u shfaqën informacione se këto dy vende kishin bërë edhe një propozim sesi Kosova dhe Serbia mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre. Ndërkaq, qytetarë të anketuar në Prishtinë dhe Beograd, siç mund të dëgjohet në këtë anketë, konfirmojnë se pak dinë për këtë propozim.

Kurti pret në takim komandantin e ri të KFOR-it

PRISHTINË, 20 TETOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të enjten në takim formal, pas marrjes së komandës të KFOR-it, gjeneralmajorin Angelo Michele Ristuccia. Së bashku me urimin për detyrën e re dhe mirëseardhjen në Republikën e Kosovës, kryeministri Kurti e njoftoi

gjeneralmajor Ristuccia për zhvillimet në vend, punën e qeverisë dhe synimet e saj, me theks te fusha e sigurisë. Falënderues për mikpritjen, gjeneralmajor Ristuccia shprehu përkushtimin dhe gatishmërinë e tij për bashkëpunim dhe koordinim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe

institucionet vartëse të sigurisë dhe rendit në shërbim të sigurisë, paqes dhe garantimit të lirisë së lëvizjes. Gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia mori komandën e KFOR-it më 10 tetor. Ai është oficeri i 13-të italian që merr komandën, si Komanda e 27-të e KFOR-it.



Totaj: Po synojmë rritjen e produktivitetit në bujqësi dhe të të ardhurave për popullsinë rurale

PRIZREN, 20 TETOR - "Prania e zonave të mëdha e të përshtatshme për bujqësi dhe blegtori ka bërë që politikat bujqësore të komunës së Prizrenit të jenë prioritete që synojnë rritjen e produktivitetit të bujqësisë e të të ardhurave për popullsinë rurale, duke rritur mirëqenien e saj përmes përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë", kështu është shprehur kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, në Parlamentin e Dytë Rural në Kosovë, që organizohet nga Rrjeti i Organizatave për Zhvillim Rural të Kosovës, e që ka për qëllim ndërtimin e

kapaciteteve, rrjetëzimin me organizatat e ndryshme që veprojnë në zonat rurale, ngritjen e vetëdijes për rolin e femrës rurale, organizimin e programeve të ndryshme mbështetëse për rininë rurale etj.

Kryetari Totaj ka potencuar se zhvillimi i qëndrueshëm i komunitetit rural, rrjedhimisht, zhvillon edhe turizmin rural, për të cilën gjë ne punojmë në vazhdimësi. Ai ka thënë se fondet shtetërore janë të nevojshme për t'u pajisur me mjete moderne të prodhimit për t'i zotëruar teknologjitë e reja dhe blerjen e pajisjeve gjë që, sipas tij, komuna e Prizrenit vazhdimisht i ka inkurajuar dhe subvencionuar bujqit.



KFOR-i dhe FSK-ja e vlerësojnë të qetë situatën e sigurisë në Podujevë



PODUJEVË, 20 TETOR - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i komunës së Podujevës (KKSB) ka mbajtur mbledhjen e rregullt në të cilën ka analizuar gjendjen e sigurisë në komunë, sigurinë në shkollë, gjendjen e pyjeve, sigurinë në komunikacion dhe trajtimin e qenve endacakë.

Lidhur me gjendjen e sigurisë në komunë, komandanti i Stacionit Policor, Nijazi Jashari, ka raportuar për të gjitha rastet e veprave të ndryshme të raportuara në polici gjatë muajve të fundit si dhe statistikën e periudhës janar-shtator. Ndërsa sa iu përket veprave

penale gjatë kësaj periudhe janë regjistruar 712, ku si incidente janë të regjistruara 240, 35 raste të aksidenteve me lëndime, 191 me dëme materiale, 52 raste me persona të lënduar, 825 raste të realizimit të urdhërësive, tiketa të shqiptuara 5 481, ndërsa raste të vjedhjeve janë 140 raste.

Përfaqësuesja e KFOR-it gjendjen e përgjithshme të sigurisë në komunën e Podujevës e ka vlerësuar të qetë si dhe ka ritheksuar gatishmërinë e KFOR-it në ruajtjen dhe sigurinë publike. Edhe përfaqësuesi i FSK-së gjithashtu theksoi që gjendja e sigurisë është stabile.

Nga janari deri në shtator u kryen 1 550 gastroskopi

PRISHTINË, 20 TETOR - Në Klinikën e Gastroenterologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nga janari deri në shtator, u kryen 1 550 gastroskopi. Për këtë periudhë kohore, në bazë të raportit të punës, u bënë edhe 1 51 kolonoskopi.

Listë të pritjes më nuk ka dhe tash qytetarët mund t'i marrin këto shërbime brenda dhjetë ditësh. Gjatë tërë vitit 2021 u realizuan 1 197 gastroskopi dhe 737 kolonoskopi, ndërsa lista e pritjes ishte deri në 7 muaj. Dyvjet më herët, në vitin 2020,

në Klinikën e Gastroenterologjisë kishte vetëm 768 gastroskopi dhe 419 kolonoskopi, me një listë pritjeje 9 muaj.

Lista e pritjes ishte e njëjtë edhe në vitin 2019, ndërsa u kryen 1 223 gastroskopi dhe 1 000 kolonoskopi.



Osmani: Liberalizimi i vizave nuk duhet të mbetet peng i teknikaliteteve të reja

PRISHTINË, 20 TETOR - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, në vazhden e takimeve me ambasadorë evropianë, ka takuar të enjten ambasadorin e Norvegjisë, të Greqisë dhe të Luksemburgut.


Në këtë takim presidentja Osmani ka ritheksuar se Kosova është vendi më proevropian dhe se populli i saj i ndan të njëjta vlera me

popujt e tjerë evropianë. Në këtë kontekst, ka potencuar se Kosova i ka plotësuar të gjithë kriteret për liberalizim vizash ndaj, sipas saj, duhet zbatuar rekomandimi i Komisionit Evropian për heqjen e vizave.

Sipas presidentes Osmani, liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës nuk duhet të mbetet peng i teknikaliteteve të reja dhe se vendimmarrja

politike duhet të ndodhë gjatë Presidencës Çeke, ndërkaq hyrja në fuqi sipas praktikave paraprake.

Në të njëjtën kohë, Osmani diskutoi me ambasadorët rëndësinë e mbështetjes për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës me të cilën gjë qytetarëve të Kosovës u mundësohet fuqizimi i të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimin e ligjit.



Arrestohet edhe një i dyshuar për vrasjen e Ivanoviqit

PRISHTINË, 20 TETOR - Policia e Kosovës e ka arrestuar më 19 tetor një person të nacionalitetit serb me inicialet M. M. nën dyshimet se ka qenë anëtar i një grupi kriminal të përfshirë në vrasjen e politikanit opozitar serb nga veriu i Kosovës, Oliver Ivanoviç.

Urdhrin për arrestimin e të dyshuarit e ka dhënë Prokuroria Speciale e Kosovës.

Oliver Ivanoviç, i cili ka udhëhequr nismën qytetare "Liria, demokracia, drejtësia" (SDP), është vrarë më 16 janar të vitit 2018 para objektit të partisë së tij në Mitrovicën e Veriut.

Përmes një komunikate për medie, prokuroria ka thënë se i

arrestuari dyshohet se ka qenë anëtar i grupit kriminal të organizuar dhe ka marrë pjesë aktive në kryerjen e veprave penale "pjesëmarrje ose organizimi i grupit kriminal".

Sipas deklaratës, për këtë person ka pasur fletarrestim në fuqi prej vitit 2019, mirëpo ai ka qenë "i paarritshëm për organet e ndjekjes". Ndërkohë autoritetet pritet t'ia caktojnë masën e paraburgimit.

Deri ku ka arritur hetimi për vrasjen e Ivanoviqit?

Deri më tani Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur tri aktakuza


për vrasjen, në të cilat nuk ka pasur ndryshime të mëdha thelbësore. Procesi gjyqësor po vazhdon ende.

Seanca e fundit në rastin e vrasjes së liderit Ivanoviç është mbajtur më 18 tetor, në të cilën një dëshmitar i mbrojtur ka refuzuar të japë deklaratë, me arsyetimet se nuk dihet i sigurt.

Aktakuza janë ngritur kundër Nedelko Spasojeviçit (oficer policie), Marko Roshiqit (qytetar i Mitrovicës së Veriut), Silvana Arsoviçit (sekretare e të ndjerit Oliver Ivanoviç), Dragisha Markoviçit (oficer policie), Zharko Jovanoviçit (oficer policie) dhe Rade Basaras (oficer policie).



Policia arreston një person të dyshuar për krime lufte në Kosovë



PRISHTINË, 20 TETOR - Policia e Kosovës ka arrestuar më 19 tetor një burrë me inicialet E. B., të komunitetit boshnjak, nën dyshimet se ai është përfshirë në veprën penale "krime lufte kundër popullsisë civile" në periudhën 1998/99 në një fshat në komunën e Istogut.

Autorizimin për arrestim e ka dhënë Prokuroria Speciale e Kosovës.

Në një komunikatë për medie është thënë se Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës ka zhvilluar "hetime intensive lidhur me krimet e kryera nga forcat e armatosura të Serbisë gjatë periudhës kohore të viteve 1998/99 në Kosovë". Sipas policisë,

prokurori i çështjes ka lëshuar aktvendim për arrestim të përkohshëm dhe ndalim policor të të dyshuarit në kohëzgjatje prej 48-orësh.

Në vitet 1998/99 në Kosovë është zhvilluar një luftë e iniciuar nga regjimi i atëhershëm serb.

Lufta ka lënë mbi 13 000 civilë të vrarë dhe mijëra të tjerë të zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008 dhe njihet nga mbi 100 vende të botës.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e saj dhe në Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë atë pjesë të territorit të saj.

Ministrja gjermane për Evropën do ta vizitojë Kosovën

PRISHTINË, 20 TETOR - Ministrja gjermane për Evropë dhe Klimë, Anna Luhrmann, do ta vizitojë këtë javë Kosovën dhe në agjendën e saj janë edhe takimet me përfaqësues të institucioneve shtetërore të Kosovës. Sipas Ambasadës Gjermane, ajo do të jetë në Kosovë më 22-

23 tetor. Vizita e saj në Kosovë vjen në kohën kur Franca dhe Gjermania besohet se u kanë ofruar një propozim liderëve të Kosovës dhe të Serbisë, që do të mund të ishte një kornizë e re për dialogun midis tyre, për arritjen e një marrëveshjeje ligjërisht të obligueshme

për normalizimin e raporteve.

Kancelari gjerman Olaf Scholz dhe presidenti francez Emmanuel Macron përmes një letre dërguar Kurtit dhe Vuçiqit më 4 shtator u kanë kërkuar palëve që të jenë të gatshme për vendime të vështira në dialog.



Abdyl Krasniqi, një nga viganët që rriti Kosova për t'i dhënë lirinë



Nga Azem SYLA, ish-komandant i përgjithshëm i UÇK-së

(Disa kujtime shumë të vërteta dhe reale dhe mendime e vlerësime për veprimtarin e çështjes kombëtare të shqiptarëve nën Jugosllavi – Serbi, Abdyl Krasniqi nga Drenoc i Malishevës)

Me Abdyl Krasniqin jam njohur në vitet 1976 – 1977. Ishte ajo një kohë kur të gjithë shqiptarët e kërkonin njëri tjetrin, dhe e gjenin vetvetiu për t'u bashkuar e vepruar e në fund për të luftuar pushtuesin, në atë kohë jugosllav e në fund serb. Ishte ky misioni që i kishin vënë vetes të gjithë shqiptarët patriotë e në mes tyre edhe Abdyl me veçoritë e tij, me veprën e tij dhe me angazhimin e tij dinamik, për të arritur atë që mjaft edhe e dyshonin në atë kohë, por që populli shqiptar i ka besuar gjithnjë idealit të Abdylit e të gjithë patriotëve të angazhuar për ta fituar lirinë e atdheut tonë të pushtuar. Koha i tregoi këto. Për të bërë një vlerësim për

figurën e Abdyl Krasniqin nuk do të jetë punë e lehtë për mua, që e konsideroj veten bashkëveprimtar me të. Duhet vënë në evidencë pra, se Abdyl u lind më 1 maj 1939 në Drenoc të Malishevës. I cili pasi mësimit e parane vendlindje, do të vijonte mesmet në shkollën Normale të Prizrenit. Ndërsa studimet për histori-geografi i kreu në Shkollën e Gjakovë, kurse Fakultetin e Historisë në Tiranë. E pas kryerjes së studimeve, krahas punës do të merrte mbi supë edhe veprimtarinë për çështjen kombëtare, që do ta çonte në dyert e papunësisë, UDB-së, torturës e burgut,

por pa ia cenuar vullnetin për të bërë atë që ishte më me vlerë për lirinë e vendit të tij dhe të bashkëkombësve të tij.

Abdyl ishte mësues në shkollën e fshatit Drenoc. Ishte një edukator i shkëlqyer i fëmijëve edhe për dituri e edhe edukim kombëtar. Ai realisht ishte një hero i veçantë i kohës së tij. Puna e tij, vepra e tij kishte dinamikë të veçantë. Jeta e tij kishte karakteristikat e një njeriu të sakrificës për të tjerët. Ai dukej se ishte i prirë për të bërë punë që të tjerët e kishin, të vështirë, të pa mundur ose nuk guxonin t'i bënin.

Ishte pikërisht ai, që fati do ta kishte caktuar, ose më mirë të them, e kishte marrë në dorë vetë fatin e tij, për të bërë edhe nxjerrjen e eshtrave të Azem Galicës, heroit të shqiptarëve, kryekomandantit të lëvizjes kaçake shqiptare, i cili qëndronte prej rreth 50 vjetësh i varrosur si askush tjetër në botë në një varr të thellë, prej nga nuk kishte guxuar askush të futej e ta

nxirrte.

Abdyl prej kohës kur i pati nxjerrë eshtrat e heroit – luftëtarit për lirinë shpella e maleve të Gllarevës, do të kishte një jetë ndryshe. Ai tashmë ishte vënë në evidencat e pushtuesit dhe mekanizmit të tij të torturës, UDB-së, si nacionalist i deklaruar, si irredentist, si kundër-sllav, si shqiptar patriot që nuk do të duronte pushtuesin dhe nuk do të ishte i bindur dhe i nënshtruar ndaj këtij pushtuesi.

Duhet theksuar se që në hapat e parë Abdyl nuk ishte vetëm. Ai kishte edhe shokë të cilët ishin me të, ishin pranë tij dhe vepronin bashkë me të. Ai duke qenë se kishte krijuar lidhje edhe në Shqipëri kishte mundësi plus për të zgjeruar në vijimësi veprimtarinë për çështjen kombëtare. Ashtu veproni ai gjithë jetën për të qenë në pozicionin që ishte me interes për atë që duhej bërë në shërbim të atdheut e të kombit.

Abdyl e kishte dhënë provën e sigurisë dhe të fuqisë fizike,

shpirtërore, psikologjike dhe morale, që atë ditë kur mori përgjegjësinë të zbriste në varrin më të thellë në botë, për të nxjerrë në dritë një element të rëndësishëm të vlerave historike kombëtare siç ishte nxjerrja prej asaj thellësi e eshtrave të Azem Galicës.

Ai arriti të futet në atë shpellë, ku përveç Azem Galicës nuk kishte zbritur askush tjetër. Kjo do të ndodhte më 22 maj 1971. Kur ai me guxim do të ndërmerre veprimin që pakkush mund ta kuptonte a ta imagjinonte në atë kohë. Ajo shpellë për të gjithë ishte një enigmë, askush nuk mund ta dinte cila ishte thellësia e saj apo struktura e saj. Aty kishte kaluar para tij veç Azem Galica, pasi e kishte dorëzuar shpirtin.

47 vjet kishin qëndruar në atë varr të veçantë eshtrat e kryetrimt. Deri kur të atë varr me thellësi prej 73 metrash, zbriti Abdyl Krasniqi, ai kishte qenë thajse një legjendë. Kurse tashmë do të kthehej në një realitet të prekshëm.

Unë në atë kohë si 20 vjeçar, e kam përjetuar me krenari këtë veprim simbol, që na dha vërtetë forcë, për të kuptuar se prej këtej do të ishim më të fortë. Ishte arritur të ngrihej Azem Galica nga nëntoka në dritë të diellit e kjo donte të thoshte shumë për ne të rinjtë, por sidomos për të rinjtë që kishin marrë mbi vete një mision, për të luftuar për atdhe e liri kombëtare. Në këto kushte, Abdyl do të bëhej synimi ynë për t'u bërë shok e veprimtar me të.

Kjo vepër madhështore e Abdyl Krasniqit bëri përshtypje të madhe për të gjithë shqiptarët. U kuptua se tashmë mund të bëheshin edhe veprime që na mbushnin kombëtarisht. Por as që mund të mendohej se punë të tilla mund të bëheshin lehtë. Sot mund të duket si një rrëfenjë dimri, për të mbushur kohën. Por në atë kohë të pushtimit të egër jugosllavo serb, për veprimtari kombëtare më e pakta që mund të të gjente, të shkonte dëm jeta. Megjithatë kishte të tillë mjaftueshëm, si Abdyl Krasniqi që nuk e përfillnin rrezikun.

Kuptohet që për veprën e Abdylit ishte informuar edhe pushtuesi. Kështu që ai vetëm 3 muaj më vonë do të largohej nga puna, duke i hequr të drejtën në mënyrë arbitrare për të vijuar më tej mësimeve, për fëmijët, detyrë të cilën ai e kishte me pasion të veçantë.

Kuptohet, Abdyl po bënte veprime që e gjallëronin shpirtin kombëtar shqiptar. Por këto bënë që ai personalisht dhe familja e tij, e fëmijët të pësonin shumë. Megjithatë ai trung familjar i dhanë vazhdimisht vetes dhe kombit krenari me qëndresën dhe me veprimtarinë e tyre në interes të atdheut e kombit. Më lejohet të them, se veprimtari si të Abdyl Krasniqit janë madhore e madhështore. Janë të tilla që na japin krenari. Janë të tilla që na japin siguri. Janë të tilla që na bëjnë të qartë vizionin për të ardhmen kombëtare. Bota i krijon nga asgjë figura të tilla kombëtare.

Kurse ne kemi privilegjin t'i kemi në mesin tonë. Kemi privilegjin të jemi bashkudhëtar, bashkëkohës e bashkëveprimtar dhe bashkëluftëtar me ta. Prandaj me këtë rast edhe do të apeloja që të bëjmë kujdes me figura të tilla. Ata nuk na kërkojnë asgjë, përveç se të vlerësojmë veprën e tyre, të mbajmë të freskët veprën e tyre dhe të mos harrojmë sfidat e historisë nëpër të cilën kemi ardhur. Të

ndihemi mirë për të folur edhe në orën e mësimit me fëmijët në shkollë për aspektet e historisë heroike të shqiptarëve në tërësi e të luftës kundër pushtuesve në veçanti, duke ardhur deri te lufta më e fundit, Lufta Çlirimtare e Kosovës e cila na dha lirinë dhe na jep krenari në të gjitha kohërat e ardhshme, si model, për të përballuar çdo lloj rreziku që mund t'i kanoset atdheut e kombit.

Guximi i Abdylit kishte një veçori nga guximi i shumëkujt. Guximi i tij ishte publik. Ai nuk përtoj për asnjë moment të ndeshet me pushtuesin publikisht. E gjithnjë pa e shkëputur veprimtarinë e fshehtë për çështjen kombëtare të cilës i ishte kushtuar. Kështu, ai bëri 19 seanca gjyqësore me mekanizmat shtetërore të pushtuesit, derisa më në fund u kthye në punë si i pafajshëm. Dhe të ndërmarrësh veprime të tilla publike akuzuese ndaj pushtuesit e njëkohësisht të vazhdosh luftën ilegale duke e shtrirë atë në gjithë hapësirat e pushtuara, kjo vërtetë është një veprimtari jo vetëm e guximshme, por edhe me një strategji të studiuar të sigurisë së vijimësisë së aktivitetit atdhetar.

Ai amaneti i Azem Galicës në momentet e ndërrimit jetë lënë shokëve të tij: "Vëllezër! Amanet atdheun, ruajeni dhe luftoni të bashkuar për lirinë e tij. Të plagosurit dhe fëmijët jetimë i përcillni në Shqipëri. Ti Shotë, mos iu ndajë çetës. E di që kurrë s'ke me e korit emrin dhe trimërinë tënde. Lamtumirë vëllezër! Kosova dhe ju më dhatë fuqi, zemër e krah lufte. Edhe i vdekur kam dëshirë me luftue bashkë me ju. Prandaj trupin më ma djeg ose më ma qit në një pus të pafund. Armiku nuk duhet ta marrë vesh vdekjen time. Trimat nuk kanë kohë të përlojnë. Shtrëngoni fort armët, lufta nuk duhet ndërprerë ...". Duket se në shpirtin, në moralin dhe në forcën e Abdyl Krasniqit, kishte zënë vend më shumë se te çdo shqiptar tjetër. Ai dukej se jetonte edhe praktikisht me viganët e historisë shqiptare. Bënte të gjitha përpjekjet të ishte në lartësinë e heronjve nëpër histori. Prandaj edhe nuk u ligisht asnjëherë.

Bashkëpunimi im me Abdylin ka qenë intensiv. Megjithëse me kalimin e viteve prej 1976 e deri më 1989, ishte arrestuar shumë herë e burgosur dhe mbajtur në burgun e Pejës. Ai mbeti publikisht i pa dëgjueshëm i



ABDYL KRASNIQI

shtetit jugosllav – serb, që mbante të pushtuar tokën tonë dhe nën zgjedhën e ligjeve të tij gjithë shqiptarët e këtyre trojeve.

Vlerësoj, se ai ishte një veprimtar shumë shumë i vendosur, për ta luftuar pushtuesin jugosllav – serb, e për t'ia sjellë lirinë popullit të Kosovës së pushtuar. Nuk vërehej asnjë lëkundje në gjithë veprimtarinë e tij. Ai ishte gjithnjë me ngutje. Donte ta bënte gjithçka menjëherë, sot dhe të pa asnjë cen. Që në atë kohë dukej sikur ai e shikonte Kosovën të çliruar, sikur i shikonte të gjitha trojet shqiptare të bashkuara. Ishte modeli i moralit kombëtar. Vuajtjet e tij ishin të mëdha. Pushtuesi e kishte në çdo kohë nën vëzhgim. Por edhe ai i rrinte gjithnjë pa u lëkundur përballë. Dhe me

këtë përballje publike, mendoj se kishte gjetur mënyrën më të sigurt për të kryer detyrat në kuadër të veprimtarisë ilegale, të cilën e kishte shumë intensive dhe të pandalshme e të pa ndërprerë. Sikur kishte gjetur çelësin për të fshehur veprimtarinë e tij kombëtare ilegale. Pasi ishte krijuar mendimi se Abdyl është ashtu rebel, i pa bindur, i pa nënshtrueshëm, deklarativ, i pa mbajtshëm, por nuk ka asgjë më tej prej tij. Kështu, në atë kohë nuk mund të mendohej se ky Abdyl deklarativ, kishte lidhjet e tij në gjithë hapësirat e tokave të pushtuara e edhe deri në Tiranë, për të plotësuar misionin e tij të cilin e kishte marrë mbi vete të organizonte me të gjitha mënyrat veprimtarinë kombëtare për çlirim.

Mirëpo, kjo mënyrë veprimi thashë se e vuri në vijimësi nën prangat e UDB-së e të policisë jugosllave – serbe. E vuri nën torturë të vijueshme, të cilat i përballon me shumë forcë shpirtërore. Por ai gjithnjë ishte shumë vigjilent. Me gjithë bastisjet e vijueshme në familje, asnjëherë nuk arritën të gjejnë ato gjëra që nuk duheshin gjetur. Ai ishte mjeshtër i ilegalitetit nëpërmjet legalitetit. Sidoqoftë, maltretimet dhe torturat e mëdha që i bëri UDB-ja, e bënë të vetën, në tortura u dëmtua shumë fizikisht. Aq dëme iu shkaktuan në trupin e tij, deri sa e bënë të pa aftë për punë. Por nuk arritën ta bëjnë të pa aftë për të vijuar luftën për çlirimin e atdheut e bashkimin e kombit. E megjithëse i pa aftë për punë

UDB-ja në vijimësi do të qëndrojë në vëzhgim të tij, por nuk do të arrij në asnjë rast të bien në gjurmët e punës së tij ilegale. E megjithëse në këto kushte dhe i diferencuar politikisht, siç ndodhte në atë kohë për të gjithë ata që nuk ishin të nënshtruar ndaj pushtuesit, ai qëndroi në këmbë për të ecur drejt lirisë për të cilën kishte vepruar gjithë jetën duke qenë i bindur se do të arrinte një ditë te ajo, liria për të cilin nuk kishte ëndërruar, por kishte investuar gjithë jetën e tij dhe gjithë familjen e fëmijët e tij për ta mbërritur.

Kujtoj me shumë ndjenjë atë thënien e tij që nuk e kishte vetëm në gojë, por edhe në mendje, në shpirt e në zemër: "Për të lindur- lypset vdekur!" Pra ai e shihte vdekjen për atdhe si lindje të atdheut, si lindje të lirisë. Kujtoj një moment në kohën e Luftës Çlirimtare të Kosovës, kur u takuam. Ishte menjëherë pasi kishin rënë në frontin e luftës duke luftuar heroikisht Fehmi Lladrovci dhe Xheva. E pasi tha ato fjalët e shpirtit se ata i takonin atdheut dhe ranë për të, i doli një zë nga zemra do të thosha: Ajo në ishte thjeshtë vajza ime, atë e kisha shok. E kujtoj atë moment me shumë ndjenjë edhe sot, sepse atë vajzë – Xhevën vërtetë edhe unë e kisha shok.

Por unë mendoj se Abdylti të gjithë fëmijët e tij djemtë dhe vajzat i kishte shokë. Gjithnjë i vlerësoj, gjithnjë u besoj, gjithnjë u ngarkoj detyra, të cilat ata i kryen me dinjitet, por që edhe ai asnjëherë nuk bëri të shqetësuarin a të kujdesshmin, për t'i shmangur fëmijët e tij dhe familjarët e tij nga rreziku. Për të e para ishte detyra për atdheun, pastaj të tjerat. Prandaj edhe gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës ai vetë i pari dhe të gjithë familja e fëmijët pas tij ishin në radhët e ushtrisë aty ku ishte rreziku më i madh, aty ku ishte nevoja më e madhe aty ku ishte situata më e vështirë.

Me mua Abdylti kishte ra në kontakt të rregullt nga vitet 1976 – 1977, siç e kam shpjeguar edhe më lartë. Në atë kohë unë punoja si profesor kimie në shkollën "Luigj Gurakuqi", në Klinë dhe në paralelen e ndarë në Kijevë.

Abdylti kishte fëmijët e tij nxënës në shkollën "Luigj Gurakuqi", në Kijevë, që kujtoj se ishin Xheva, Servetja, Sabrija. Sabrija ishte e Ibrahimit (axhës) së Abdylit, një i moshuar në atë kohë, por me orientim dhe bindje patriotike të qarta.

Ibrahim Krasniqi, axha i Abdylit ishte një burrë i qetë, shumë i ndjeshëm dhe inteligjent në mendime dhe i guximshëm për të mos e dëgjuar regjimin e pushtuesit jugosllav – serb.

Abdylti me axhën Ibrahimin ishin ra në sy të pushtuesit si kundërshtarë të tij dhe të regjimit që ai kishte instaluar në trojet e pushtuara shqiptare.

Abdylti ishte i tillë, që pavarësisht nga ne të tjerët, ai furnizohej me literaturë ilegale patriotike nga Republika e Shqipërisë, pasi ai kishte lidhjet dhe linjat e veta të furnizimit prej andej. Abdylti kishte lidhje me njerëz dhe me familje të ndryshme shqiptare anembanë Kosovës dhe trojeve të pushtuara nga Jugosllavia – Serbia.

Unë kalova shkurt nëpër këtë jetë vigani, sepse nuk mundem të detajoj gjithë veprimtarinë e tij, pa thënë se seancat e shumta gjyqësore, torturat psiko-fizike nëpër dhomat e hetuesive dhe vuajtjet e gjata në birucat e errëta të burgjeve të ndryshme jugosllavo serbe paraqesin një histori që unë as që mendoj se mund ta paraqes, sepse ajo është shumë e ngarkuar, siç është e ngarkuar edhe jeta ime, por që për këtë kohë e kam lënë në hije, sepse duhet kohë e qetësi në shpirt për t'u marrë me të. Qetësi të cilën akoma nuk e kam e që uroj ta kem kur të përfundojë lufta e të ndihemi plotësisht të çliruar.

Abdylti si veprimtar publik për atdheun e kombin e tij prej vitit 1971 deri më 1996, është dënuar mbi dhjetë herë nga shtatë ditë e deri me pesë vjet burg.

E megjithatë bastisjet dhe përndjekjet e familjes së tij nuk kishin të sosur. Kështu vetëm brenda muajit tetor të vitit 1995 pati tetë bastisje në shtëpinë e tij, gjatë të cilave u demoluan të gjitha orenditë duke u kërkuar armë dhe djalin i tij, Fitimin. E ato ditë ishte kidnapuar edhe vajza e tij, Servetja, studente e rregullt e Fakultetit të Bujqësisë në Prishtinë dhe për një kohë të gjatë qe mbajtur në Burgun e Smrekonicës, pa ditur gjë për fatin e saj.

Ashtu do të vijohej me arrestimin dhe burgosjen e tij me tre të bijtë: Atomin, Hlimin dhe Fitimin, më 14 prill 1994, pastaj maltretimit të djalit të vogël, Kushtrimit në klasën e tetë etj.

Abdylti në vitin 1981, kur u bënë demonstratat masive në Kosovë, ishte gati të marrë përgjegjësi si kombëtare, organizative, rezistuese e

deri në rezistencë të armatosur, për Republikën e Kosovës.

Në ngjarjet e prillit 1981, ne, grupi ynë i drejtuar nga Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Gani Sylja, Nezir Myrta e shumë të tjerë, karshi kohës e ngjarjeve të zhvilluara, bëmë përpunimin prej nga dolën "Tezat e Frontit për Republikën e Kosovës".

Në këtë organizim unë në territorin Klinë – Kijavë e më gjerë patëm rekrutuar dhe organizuar afër 60 – 70 anëtarë për "Frontin e Republikës". Që Abdylti Krasniqi edhe me fëmijët e vet dhe rrethin e gjerë të njerëzve të njohur të idealit, ishte ngarkuar të jetë një prej drejtuesve në këtë territor e më gjerë.

Unë mbaja lidhje të drejtpërdrejta me shtetin e Shqipërisë, por edhe Abdylti kishte lidhjet e veta të drejtpërdrejta me shtetin e Shqipërisë.

Në vitet 1978 deri më 1989, lëvizjet për në Shqipëri i bëja sipas nevojës.

Me Abdyltin kishim besim të plotë të bisedonim me njëri tjetrin, por në marrëdhëniet me shtetin e Shqipërisë vepronim secili në veçanti për punët që kryenim.

Për të krijuar një bindje të qartë se sa i madh ishte besimi dhe lidhja mes nesh, kujtoj se në një moment, Abdylti më thotë, se unë kam nevojë për të shkuar në Shqipëri, por e kam të pamundur pasi një këmbë e kam të sëmurë e nuk mund të eci. (Kuptohet, në ato kohë rrugët për në Shqipëri ishin me rreziqe të mëdha, pasi përveç që duhej ecur në këmbë nëpër male, në të ftohet, borë e acar, apo të nxehtë e pa ujë e bukë, por ishte edhe më i madh rreziku të diktoheshim dhe të vriteshim ose të ziheshim e të torturoheshim në vijimësi dhe të dënoheshim me burgime të gjata apo edhe të likuidoheshim. E bëra këtë shënim sepse mund të ketë prej atyre që të mendojnë se ka qenë lehtë siç është sot për të shkuar në Shqipëri.) Prandaj më tha, meqenëse ju do të shkoni unë në besim ta jap një fëmijë me vete nëse ma pranoni shoku Azem.

Unë pranova të marrë me vete një nga fëmijët, që nuk kujtoj cila ka qenë nga vajzat Xheva, Servetja, apo Sabrija, që do të duhet ta saktësoj në kujtimet e mia të mëvonshme, pasi njëra prej këtyre ka ardhur me mua në atë rrugëtim për në Shqipëri. Vajza që ishte me mua në atë rrugëtim, kishte me vete porositë e Abdylit, bashkë me një material të shkruar

rreth 50 apo 60 faqesh.

Ndërsa unë kisha çështjet e mia që do të trajtoja dhe për të cilat kisha marrë këtë rrugëtim. Rrugëtimin e bëmë bashkë në vajtje dhe në kthim.

Shënim: Ishte rregull i përcaktuar rreptë, që lëvizjet në Shqipëri dhe kontaktet të mos t'i dinë as pjesëtarë të grupit në të cilin isha i organizuar. Për mua një veprim i tillë kishte rëndësi të madhe se siguronte fshehtësinë e veprimit. Por siç thash me Abdyltin lidhjet ishin shumë të forta dhe ne vepronim bashkë, megjithëse pa e zbuluar plotësisht sekretin e veprimit midis nesh.

Dalim në vitet 1989 – 1990 – 1991 – 1992 – 1993, kur ishin krijuar kushtet për mendim, veprim të rezistencës së armatosur për liri të Kosovës. Tani Abdylti Krasniqi i kishte të gatshëm tërë familjen – apo të gjithë fëmijët e tij për të kontribuar në luftën e armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në vitin 1993 – 1994, Halim Abdylti Krasniqi, bashkë më vëllain Atomin kapen në Maqedoni, duke bartur armë për përgatitjen e armatosjes së UÇK-së.

Halimi dhe Atomi në Maqedoni kapen nga policia. Ata në këtë rrugëtim ishin të shoqëruar edhe nga vëllai i Ali Ahmetit – Fakriu dhe vëllai i Fazli Veliut -emri i të cilit për momentin nuk po më kujtohet, dhe Behxhet Luzha.

Djali i Abdylit i madhi Selajdini ishte punëtor në Zvicër, që edhe ky ishte i organizuar dhe shumë aktiv në radhët e LPK-së dhe kontributdhënës i vazhdueshëm për luftën, lirinë e Kosovës, i pa ndalur deri në pakufi.

Po kështu Selim Abdylti Krasniqi, i kthyer nga Gjermania angazhohet në UÇK, duke bërë një vepër të madhe për çlirimin e Kosovës. Ashtu edhe Betimi, Kushtrimit etj.

Abdylti vetë tashmë ndiqte nga afër të gjitha lëvizjet për organizim dhe për aktivitetin luftarak të djemve dhe vajzave të tij e të gjithë shqiptarëve në radhët e UÇK-së. Ai ishte vazhdimisht pranë strukturave të UÇK-së, duke u kujdesur, duke kërkuar, duke ndihmuar, duke këshilluar për të bërë më të mirën për luftën e çlirimin nga pushtimi dhe fitoren e lirisë të cilës i kishte kushtuar gjithçka pa hezitim gjatë gjithë jetës.

Pra, Abdylti ishte vetë aktiv në UÇK, por edhe djemtë e vajzat e tij të gjithë, siç kujtoj Atomin, Selimin, Halimin,

Fitimin, Shqipen, etj.

Por ai do të bënte thirrje të vazhdueshme për të gjithë që duke vlerësuar e vështruar gjendjeneshypëse dhe mbytëse në Kosovë, kur dhuna e terrori i pushtuesit serbo-sllav mbi popullin e pushtuar shqiptar vazhdon me përmasa shqetësuese, duke shkelur të gjitha të drejtat: qytetare, njerëzore e kombëtare, të një populli, që kërkon të ketë të drejta dhe barazi si çdo popull tjetër ftohen të gjitha forcat politike në Kosovë, të jenë serioze dhe unike në shërbim të kohës dhe kombit në përgjithësi, në kuadër të përcaktimit, qëndrimit, vullnetit, vendimit dhe fjalës së popullit, që ishte lufta e armatosur për çlirimin e vendit nga pushtimi 100 vjeçar jugosllav e serb.

Pra, Abdylti Krasniqi ishte nga nismëtarët ekrijimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që rrugën për të arritur aty e kishte nisur herët. Ai ishte i njohur, i dashur dhe i nderuar e i respektuar prej të gjithë udhëheqjes së luftës dhe ishte gjithnjë aty pranë me gjithë fuqinë e tij për të bërë më të mirën. Ashtu sikurse gjatë gjithë jetës së tij ai do të ishte i ndodhur gjithkund nëpër trojet shqiptare të pushtuara, duke mbajtur gjithnjë në veprim edhe gjithë formacionin e fëmijëve të tij, që i dhanë gjithë kapacitetet e tyre atdheut dhe vijuan edhe pas çlirimit të kenë probleme me ata që qëndrimi dhe lufta e tyre u ka prishur harmoninë me jugosllavët e serbët. Ashtu siç akuzohet gjithë UÇK-ja, nuk kanë shpëtuar edhe fëmijët – tash burra e gra – të Abdylti Krasniqit.

Abdylti ndërroj jetë më 20 dhjetor 2009, lindi më 1 maj 1939 në Drenoc të Malishevës. Ai e pa dhe e përjetoj Kosovën të shpallur shtet të pavarur, dhe jam i bindur se ka shkuar me ëndërr të plotësuar ani pse kjo nuk u arrit pa sakrificë edhe të tij e fëmijëve të tij, siç edhe pa sakrificat e gjithë shqiptarëve të ndershëm e patriotë.

Sot akoma ka shqiptarë që e mallkojnë dhe shpifin për UÇK-në. Tani edhe ushtri kërkojnë një tjetër, edhe luftëtarë kërkojnë të tjerë, vetëm ata që bënë luftën nuk janë të mirë. Lufta u bë. Mirë u bë. Ata që dhanë jetën ishin të mirë. Por këta që na çliruan janë të këqij. Më vjen keq për ata shqiptarë që kanë rënë në këtë nivel. I mëshiroj. Por nuk i fali.

Kriza energjetike detyron Gjermaninë të dalë me plan për zgjatjen e jetës së centraleve bërthamore



BERLIN, 20 TETOR - Ministri gjerman i Ekonomisë dhe ai i Ambientit kanë hartuar një draft-dokument për ta zgjatur jetën e tre centraleve të mbetura bërthamore në këtë shtet deri më 15 prill të vitit 2023.

Kancelari gjerman Olaf Scholz ka urdhëruar ministrat që të punojnë në

kornizën ligjore për t'i mbajtur centralet operacionale.

Ekonomia më e madhe e Evropës pati planifikuar mbylljen e centraleve deri në fund të këtij viti, mirëpo Scholz tani është duke shtyrë përpara zgjatjen e afatit, pas krizës me energji që ka nxitur lufta e Rusisë në Ukrainë.

Pas ndryshimeve në Aktin Atomik të Energjisë, që parasheh zgjatjen e jetës së centraleve, draftligji duhet të kalojë përmes kabinetit dhe të tria partitë e koalicionit duhet të pajtohen me të. Ky dokument më pas duhet të miratohet edhe në të dyja dhomat e parlamentit deri në fund të muajit nëntor.

Gërxfhaliu: Në këtë kohë a ka kuptim të flitet për 260 euro pagë minimale?

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 20 TETOR - Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxfhaliu, ka bërë me dije se në raportin e fundit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën është theksuar se një ndër institucionet më joaktive ka qenë Kuvendi i Kosovës dhe angazhimi i deputetëve. Gërxfhaliu thotë se ajo çfarë është thënë në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën, veçanërisht për Kuvendin qëndron. Sipas tij, deputetët e Kuvendit të Kosovës ende nuk arritën që ta ngrehin zërin për miratimin e Projektligjit për

Pagën Minimale, e cila, siç është propozuar, nuk do të ketë efekt pozitiv te qytetarët për shkak të krizës ekonomike që ka kapluar botën.

“Se vërtet qëndron një fakt i tillë është dëshmia më e mirë se paga minimale ka filluar të debatohet me vite të tëra dhe ende nuk është miratuar në Kuvend. Propozimi ka qenë që ajo pagë të jetë 260 euro. Dhe shtrohet pyetja: A ka kuptim sot të flitet për 260 euro pagë minimale? Keni parasysh inflacionin është mbi 20 për qind, kur kemi ngritje të çmimeve më tepër se 120 për qind dhe e tërë kjo falë neglizhencës së deputetëve në Kuvendin e Kosovës dhe si pasojë e mungesës së

përgjegjësisë qoftë individuale dhe institucionale ka devaluuar dhe degraduar tema për pagën minimale”, ka thënë Gërxfhaliu për gazetën “Epoka e re”.

Gërxfhaliu ka theksuar se sot në këtë kohë krize ekonomike globale kjo pagë minimale do të duhej ishte dyfishi i asaj që është propozuar. “Sot do të duhej të ishte dyfishi i asaj page minimale, sepse çfarë ke blerë vitin e kaluar me 100 euro, këtë vit nuk mund të blesh me 200 euro. Kush mban përgjegjësi në këtë kohë të krizës ekonomike dhe sociale të mos ketë azhuritet në Kuvendin e Kosovës, që këto ligje të trajtohen me prioritet. Në qoftë se në këtë kohë të krizës e cila ka goditur mbarë botën, në

veçanti Evropën dhe Ballkanin Perëndimor, Kosova tenton ta minimizojë efektin negativ të kësaj krize; nëse në këtë krizë nuk ka gatishmëri të deputetëve të Kuvendit që të trajtojnë ligje me prioritet si Ligji për Pagën Minimale, do të thotë është dëshmia dhe mjerimi më i madh që karakterizon politikbërjen në Kosovë. Kjo është edhe një dëshmi se në Kosovë luftohet për pushtet dhe jo për shtet. Pra, në Kosovë luftohet për karrige dhe jo për qytetarët”, është shprehur Gërxfhaliu.

Ai thotë se qytetarët e Kosovës nuk janë duke e ndierë ndihmën e shtetit. “Prandaj është koha urgjente që të kemi një zgjim institucional, të

avancohet dialogu publiko-privat, të avancohet dialogu tri partitë, të bisedohet me biznese, të ketë kalkulime faktike dhe jo të besohet në statistikat jo të sakta me të dhëna të gabuara. Është koha që të kthehet dinjiteti i humbur te qytetarët e Kosovës dhe të kthehet shpresa e humbur se në Kosovë mund të jetohej dhe do të ketë ardhmëri. Në qoftë se vazhdohej në këtë mënyrë, atëherë nuk duhet të na brengosë fakti se Kosova do të ballafaqohet me një pandemi demografike që do të jetë efekti më pozitiv i arritur nga armiqët shekullorë të Kosovës”, ka thënë ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxfhaliu.

Studentët mund të aplikojnë për marrjen e 100 eurove nga shteti

PRISHTINË, 20 TETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka njoftuar se nga dita e enjte është hapur aplikimi për studentë për të përfituar nga pakoja për përballje me inflacion. “Sot në

eKosova është hapur aplikimi për studentë, për të përfituar nga mbështetja e njëhershme me 100 euro. Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët aktivë që studiojnë në programet e akredituara në Republikën e

Kosovës”, ka shkruar Murati në “Facebook”.

Ai ka bërë me dije se aplikimi do të jetë i hapur deri më 6 nëntor në platformën eKosova, ngjashëm sikurse herën e kaluar për studentët shtetas dhe

joshtetas që studiojnë në Kosovë. Pas mbylljes së aplikimit, listat do të verifikohen me institucionet arsimore të akredituara dhe listat e konfirmuara do të procesohen për pagesë.



Mali Olimp, vendbanimi i Zotave: Miti përkundrejt realitetit



Pak male kanë pasur një ndikim më të madh në historinë e qytetërimit perëndimor sesa ai që ndodhet në bregdetin e Egjeut në kufirin midis Thesalisë dhe Maqedonisë, i njohur si Mali Olimp. Përgjatë shekujve, ky mal ka pasur një rëndësi të madhe, jo vetëm në mitologji, por edhe në gjeologji dhe ekologji.

Në rrafshin mitik, perënditë e lashta greke që jetonin në majë të malit Olimp u shfaqën për breza në fe dhe kulturë, arkitekturë dhe letërsi. Edhe sot ritregohen mitet e perëndive të malit Olimp. Në aspektin fizik, masivi i Olimp, që përmban majën që njihet si mali Olimp, është vendi i një përmbysjeje ku shkëmbinjtë granitikë, metamorfikë dhe ofiolitikë janë ngritur mbi depozitat e lashta gëlqerore.

Për më tepër, rajoni i Olimp ka një biodiversitet të madh. Për këto arsye, mali Olimp është brenda një biosfere e mbrojtur nga UNESCO-s, dhe pjesë e parkut kombëtar më të vjetër në Greqi. Ai vazhdon të ndikojë edhe sot në historinë e njerëzimit.

Mali Olimp është në fakt një nga disa majat në masivin e Olimp. Maja që besohet se ishte vendbanimi i perëndive të grekëve të lashtë është një zonë e gdhendur nga akullnajat, dhe është maja më e lartë në Greqi. Mali Olimp ndodhet buzë Detit Egje. Shpatet e tij ngrihen në një lartësi deri 2918 metra mbi nivelin e detit.

Topografia në anën perëndimore është mesatarisht më e butë, duke i lënë vendin fushës së Thesalisë. Shpatet e poshtme të malit Olimp kanë një klimë tipike mesdhetare, me pemë lisi dhe bimësi të ulët. Në lartësinë mbi 600 metra, pyjet e dushkut ia lënë vendin pyjeve të ahut, dhe pishës së zezë.

Në lartësinë mbi 2500 metra, pyjet i lënë vendin bimësisë së ulët sub-alpine. Mali Olimp është më i njohur për perëndimorët si vendbanimi i perëndive olimprike nga mitologjia e lashtë greke. Në Iliadën e Homerit, ku vend

përshkruhet me hollësi si një akropoli i lashtë grek, ose si kompleks pallatesh i fortifikuar.

Akropoli u ndërtua nën majën kryesore, e cila funksiononte si një nga fronet e Zeusit. Brenda akropolit gjendeshin pallatet që u përkisnin perëndive. Në mes, pallati kryesor i Zeusit, dhe pallatet më të vogla të Zotave të tjerë. Portat e arta të akropolit ruheshin nga tre Horae, që ishin Perëndeshat e stinëve.

Ndërtesat e kompleksit ishin ndërtuar me gurë me themele prej bronzi, të rrethuara me oborre të shtuara me ar. Pallati i Zeusit kishte një sallë qendrore me dhoma gjumi private dhe anash me dhoma për magazinime materiale, duke pasqyruar strukturën e pallateve tipike greke të lashta të periudhës kohore të Homerit.

Salla kryesore përdorej për mbajtjen e mbledhjeve të Perëndive ashtu edhe për festat e tyre. Përpara pallatit kryesor ndodhej një oborr i madh ku mblidheshin shpesh Perënditë. Gjatë festave të tyre, ata konsumonin ambrozinë dhe nektar. Këto substanca vinin ose nga livadhet pranë lumit që rrethon botën, Okeanos, ose nga tymi që dilte nga sakrificat e bëra nga njerëzit.

Perënditë olimprike sunduan mbi universin pikërisht nga ky vend mbresëlënës. Grekët e lashtë besonin se maja e malit Olimp ishte përherë pa re. Se aty nuk kishte kurrë stuh, diçka që nuk është e vërtetë për malin historik Olimp. Gjithashtu besonin se maja e malit Olimp ishte afër majës së kupolës që formonte qiellin.

Dymbëdhjetë Zotat e Olimp ishin Zeusi, Hera, Demetra, Hestia, Poseidoni, Hefesti, Aresi, Apolloni, Artemida, Hermes, Afërdita dhe Athina. Të gjithë përveç Hadesit jetonin në malin Olimp. Ata ishin një familje me origjinë të ndryshme. Kështu Zeusi, Hera, Demetra, Hestia, Poseidoni dhe Hades ishin fëmijët e Kronit dhe Reas.

Sipas mitit grek, Kroni donte të pengonte një nga pasardhësit e tij që ta rrëzonte atë si sundimtar i universit. Ai e shtyu atë të hante të gjithë fëmijët e tij, me përjashtim të Zeusit, të cilin Rea mundi ta fshihte nga burri i saj. Më vonë Zeusi e detyroi Kronin që të vjellë nga barku fëmijët e tjerë përpara se ta mundte. Zeusi ishte Perëndia i qiellit dhe i motit, përveçse ishte sundimtar i perëndive të tjera. Hera ishte Perëndeshë e grave dhe e yjeve. Hestia ishte Perëndeshë e Tokës. Demetra ishte Perëndeshë e bujqësisë dhe Poseidoni ishte Perëndia e detit. Hefesti dhe Aresi, ishin të dy fëmijët e Herës dhe Zeusit.

I pari ishte Perëndia e artizanëve, përfshirë skulptorët dhe metal-bërësit. Aresi ishte Zoti i luftës, por edhe i guximit dhe rendit civil. Zotat si Athina, Apolloni, Artemisa dhe Hermes ishin fëmijët e Zeusit nga lidhjet e tij të shumta. Lindja e Athinës është veçanërisht interesante.

Thuhet se Athina doli nga koka e Zeusit një ditë kur ai kishte një dhimbje koke. Pasi Zeusi pati marrëdhënie seksuale me Metisin, nënën e Athinës, ai mësoi nga Gaia se fëmija i tyre i parë maskull do ta rrëzonte nga pushteti, ashtu siç kishte rrëzuar të atin, Kronin.

Duke përdorur strategjinë e babait të tij, Zeusi e gëlltiti të dashurën e tij Metis. Por fëmija i tyre, Athina, doli më vonë nga koka e tij, duke u bërë Perëndeshë e mençurisë, arsyes praktike, luftës dhe qytetërimit urban. Apolloni ishte një Zot i lidhur me profecinë dhe muzikën, ndërsa Artemisa ishte e lidhur me gjuetinë dhe lindjen e fëmijëve.

Në aspektin historik, masivi i Olimp, filloi të formohej gjatë Epokës së Eocenit (35-55 milionë vjet më parë), kur shtresat e shkëmbinjeve kristalorë dhe detarë u futën mbi shtresat gëlqerore. Shtresat e gurit gëlqeror i përkasin epokave Mezozoike ose Kenozoike.

Gjatë Epokës së Pleistocenit, mali Olimp ishte i pushtuar nga akullnajat. Faza e parë e tyre nisi para vitit 200.000 Para Krishtit. Këto akullnaja formuan luginat por dhe majat akullnajore, si mali Olimp. Periudha e fundit e akullnajave në rajonin e malit Olimp ishte rreth vitit 9500 para Krishtit.

Për shkak të lartësisë së tij të madhe dhe vendndodhjes pranë detit Egje, mali Olimp përmban një shumëllojshmëri mikroklimash, të cilat kanë çuar në një biodiversitet të madh brenda rajonit të malit Olimp. Veç bimëve kjo zonë gjithashtu ka lloje të bollshme gjitarësh, shpendësh, amfibësh dhe zvarranikësh.

Disa nga speciet në rajonin e Olimp janë endemike për Greqinë dhe Ballkanin, nuk gjenden askund tjetër në botë. Në total, brenda Parkut të Malit të Olimp ka mbi 1700 lloje të ndryshme kafshësh. Mes tyre mbi 100 lloje zogjsh, përfshirë shumë lloje skifterësh dhe gupakësh, dhe deri në 30 lloje gjitarësh. Po ashtu, aty jetojnë rreth 30 lloje zvarranikësh dhe amfibësh. Njerëzit më të hershëm që jetuan në afërsi të malit Olimp ishin ndoshta Neandertalët. Dëshmia më e hershme arkeologjike e komuniteteve të Neandertalit pranë malit daton rreth vitit 100.000 Para Krishtit. Njerëzit e parë modernë, Homo sapiens, hyjnë në këtë zonë rreth 40.000 vjet më parë.

Deri në vitin 8000 Para Krishtit, njerëzit jetonin në banesa pjesërisht të nëndheshme rreth malit. Ndërkohë rreth vitit 800 Para Krishtit, ata filluan të ndërtonin shtëpi prej guri. Nuk dihet se çfarë gjuhe flisnin banorët më të lashtë të rajonit. Por populli më i hershëm helen në rajon ka mbërritur atje ndoshta gjatë mijëvjeçarit III para Krishtit.

Më vonë ky grup u nda në grupe që përbënin njerëzit e rajonit të Egjeut, përfshirë maqedonasit, mikenasit, pellazgët, dorianët dhe grupe etj.

Nuk dihet me saktësi se kur grekët e lashtë filluan të tregonin histori për malin Olimp, apo kur e cilësuan për herë të parë si të shenjtë.

Megjithatë, ka të ngjarë që disa mite greke të jenë frymëzuar nga ngjarjet e vërteta gjeologjike në parahistorinë njerëzore në rajonin e Olimp. Një shembull është dëshmia e përplasjes së një asteroidi apo komete, e cila mund të ketë frymëzuar histori rreth betejave midis Zotave.

Në kohën e Homerit (viti 800 Para Erës Sonë), grekët e lashtë e konsideronin si të shenjtë malin Olimp. Në majën e Shën Antonit, një nga majat më të ulëta (2817 metra) pranë malit Olimp, ka dëshmi se dikur ka ekzistuar një faltore ku bëheshin fljime për nder të Zeusit. Përveç të qenit një zonë e shenjtë, zona rreth malit Olimp ka pasur edhe shumë beteja për shkak të pozicionit të saj strategjik midis Maqedonisë dhe Thesalisë. Rëndësia kultike e malit Olimp vazhdoi në epokën e krishterë, pasi atje ekzistojnë nde sot disa vende të shenjta të krishtera. Kapela e Elias, që ndodhet në lartësinë më të lartë në botën ortodokse lindore, është ndërtuar në lartësinë 2803 metra.

Për shkak të rëndësisë së tij në mitologjinë greke dhe fenë e lashtë greke, mali Olimp filloi të përfaqësojë një mbretëri idilike qiellore dhe t'i referohej më pak vetë malit fizik. Sot, nuk është e pazakontë që majat e rëndësishme të emërtohen sipas malit Olimp. Të paktën 20 male janë emëruar sipas malit Olimp, nëntë në Amerikën e Veriut, disa në Egje dhe madje disa në Australazi. Për më tepër, të paktën një mal jashtëtokësor mban emrin e malit Olimp: mali gjigant vullkanik, Olympus Mons, në planetin Mars.

Marrë me shkurtime nga ancient origins – bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Robin Mitchelli emërohet president i ANOC-ut

Suel, 20 tetor (ER) - Robin Mitchell është emëruar president i ri i ANOC-ut në Asamblenë e 26 të Përgjithshme, e cila është

mbajtur në Seul të Koresë së Jugut. Mitchell është nga Fixhi dhe do ta drejtojë ANOC-un në mandatin 2022 - 2026. Sheikh

Joaan bin Hamad Al-Thani është emëruar zëvendëspresident. Të dytë janë zgjedhur pa kundërkandidatë. Në punimet e asamblesë po

marrin pjesë edhe drejtuesit e Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK), presidenti Ismet Krasniqi dhe sekretari i përgjithshëm Besim Aliti.



Kosova luan dy miqësore në muajin nëntor

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Kombëtarja e Kosovës në futboll do t'i luajë dy ndeshje miqësore në muajin nëntor të cilat do t'i shërbejnë përzgjedhësit Alain Giresse për ta përgatitur ekipin për ciklin e ri kualifikues për Kampionatin Evropian 2024 i cili nis në muajin mars të vitit të ardhshëm.

Miqësoren e parë Kosova do ta luajnë kundër Armenisë, më 16 nëntor, më pas do të përballet me Ishujt Faroe më 19 nëntor,

kundërshtar me të cilin janë ballafaquar edhe më parë. Të dyja këto ndeshje do të zhvillohen në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë.

Kosova ditë më parë ka mësuar rivalët e grupit për kualifikimet e "Euro 2024", ku bën pjesë në Grupin I, së bashku me Zvicrën, Izraelin, Rumaninë, Bjellorusinë dhe Andorrën. Ndeshjen e parë kualifikuese Kosova do ta luajë si mysafire kundër Izraelit më 25 mars.



Fitojnë Ballkani dhe Drenica

PRISHTINË, 20 TETOR (ER) - Ballkani ka shënuar fitore të rëndësishme me rezultat 2-0 ndaj Trepçës '89 në kuadër të Albii Mall Superligës së Kosovës në futboll. Golat për suharekasit i kanë realizuar Eralp Krasniqi (48) dhe Albion Rrahmani (75 nga penalltia). Fitore të madhe ka shënuar edhe Drenica në udhëtim te Gjilani me rezultat 0-2. Kuqezinjtë kanë fituar me dy gola të shënuar në fund të

ndeshjes. Fillimisht ka realizuar Osman Mëziu (80), ndërsa pas gjashtë minutave fitoren e ka vulosur Eralp Veliqi. Me këto rezultate Ballkani është në vendin e dytë me 25 pikë, dy më pak se Drita e cila është në vendin e parë me 27 pikë, por ka dy ndeshje më shumë të zhvilluara. Ndërsa Trepça '89 është në vendin e tetë me dhjetë pikë, Drenica në vendin e pestë me 15 pikë dhe Gjilani në vendin e katërt me 18 pikë.

Tifozët e Lazios e kërkojnë rikthimin e Muriqit

ROMË, 20 TETOR - Lazio e ka marrë një lajm të keq. Sulmuesi kryesor Ciro Immobile ua ka "këputur këmbët" tifozëve pasi ka pësuar një lëndim, më saktësisht një tërheqje muskulore, e cila do ta lë atë jashtë fushës së blertë për së paku 40 ditë. E në postimin Lazios në rrjetet sociale për lëndimin e përfaqësuesit italian janë vërejtur disa komente të papritura të tifozëve.

Disa prej tyre e kanë kërkuar rikthimin e Vedat Muriqit në kryeqytetin italian, shkruan mediumi italian "lalaziosiamonoi". "Urime

bomber", "Kthehu Vedat", "Na mungon Pirati" etj. ishin disa prej komenteve të tifozëve "Biancocelesti" në rrjetet sociale, duke e kërkuar rikthimin e prizrenasit në Lazio përkundër përvojës së tij dëshpëruese për një vit e gjysmë në "Olimpico".

Shpërthimi i 28-vjeçarit në Mallorca ka bërë që tifozët e Lazios ta duan atë në skuadrën e zemrës. Megjithatë, një gjë e tillë do të jetë e vështirë të ndodhë pasi klubi ishullor spanjoll e ka blerë kartonin e ish-futbollistit të Rizesporit dhe Fenerbahçes.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "D&C Partners" - Sh.P.K, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 810540246 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "D&C Partners" d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 810540246 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that "D&C Partners" L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 810540246, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Naser Mehmet Berisha shpall të pavlefshme certifikatën Profesionale nga mbrojtja e zjarrit të lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave të MPB-së, të Republikës së Kosovës.

- Naser Mehmet Berisha shpall të pavlefshme Diplomën e Bachelorit si dhe Diplomën e Masterit të Kolegjit "Biznesi" Prishtinë.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1904